

REFERENCË

Një partner i besueshëm që e kupton vërtet brendin BioGaia

Duke kërkuar të zgjerojmë shtrirjen e produkteve tona probiotike, ne filluam partneritetin tonë me Ewopharma mbi një dekadë më parë, në vitin 2007. Pas lançimeve të suksesshme në disa vende, bashkëpunimi ynë është rritur duke përfshirë regjistrimin, shpërndarjen, shitjen dhe marketingun e produkteve BioGaia në 15 vende në tregjet e Europës Qendrore e Lindore.

Gjatë këtyre viteve, ne kemi përfituar jo vetëm nga përvoja e gjërë e Ewopharma në këto tregje, por edhe nga ekspertiza e tyre në fushat e marketingut mjekësor dhe konsumator. Kuptimi i tyre i vërtetë për produktet tona dhe BioGaia si brend i ka bërë ata një nga tre partnerët tanë kryesorë në nivel global.

Ne e vlerësojmë Ewopharma si një partner shumë profesional të cilit mund t'i besojmë plotësisht. Ne me siguri do t'a rekomandonim atë për çdo kompani që kërkon të shfrytëzojë potencialin e këtyre tregjeve në rritje (vetëm mos u tregoni konkurrentëve tanë).

Si një kompani inovative e kujdesit shëndetësor e themeluar në Suedi, BioGaia është një lider botëror në suplementet dietike probiotike për gati 30 vjet. Produktet tona synojnë të përmirësojnë mirëqenien e përgjithshme të konsumatorëve duke promovuar shëndetin optimal të tretjes. Si i tillë, objektivi i BioGaia është të jetë i disponueshëm kudo që konsumatorët kanë nevojë për qasje në probiotikë. Duke pasur këtë në mendje ne filluam bashkëpunimin tonë me Ewopharma në vitin 2007. Që atëherë, ne jemi zgjeruar në mbi 100 shtete, 15 prej të cilave janë falë bashkëpunimit tonë me Ewopharma - një nga tre partnerët tanë kryesorë për shitje dhe shpërndarje.

Meqenëse produktet tona kryesore janë krijuar për të lehtësuar dhimbjet e barkut tek foshnjat, shumë nga konsumatorët tanë janë prindër të shqetësuar me një fëmijë të pangushëllueshëm. Rrjedhimisht, kontakti i parë me BioGaia është shpesh nëpërmjet një mjeku, ku prindërit kërkojnë ndihmë dhe mbështetje. Falë rrjeteve të gjëra lokale të Ewopharma dhe ekipeve të shitjeve me ekspertizë mjekësore, ata mund të tregtojnë me sukses produktet e BioGaia tek profesionistët mjekësorë në secilin prej tregjeve të Europës Qendrore e Lindore. Pas këtij kontakti fillestar, prindërit ndihen të fuqizuar për t'i dhënë fëmijës së tyre pika qetësuese BioGaia dhe kështu kthehen prapë në barnatore për këtë brend paramjekësor. Në këtë pikë, marketingu i konsumatorit është vendimtar për rritje, pasi ruan marrëdhënien fillestare të brendit dhe me kalimin e kohës ngritet mbi këtë bazë. Ekspertët e marketingut në selinë e Ewopharma në Zvicër dhe ata në regjion e kuptojnë vërtet brendin BioGaia. Kjo na ka mundësuar të shfrytëzojmë fuqinë e mediave offline dhe online – duke nxitur angazhimin e konsumatorëve dhe duke rritur shitjet. Ekspertiza e disa partnerëve qëndron në njërin nga këto dy fusha, por Ewopharma mund t'i bëjë të dyja – marketingun mjekësor dhe atë të konsumatorit – që është gurthemeli i suksesit tonë në rajon.

Ne e shikojmë Ewopharma-n si një partner të besueshëm – ndihemi të sigurt duke ditur se të dyja palët ndajnë të njëjtat interesa dhe janë në linjë në veprimet e tyre. Për më tepër, të kesh një pikë kontakti me një shtrirje kaq fantastike na kursen shumë kohë dhe na jep qetësi mendore. Ne gjithashtu vlerësojmë pikëpamjen afatgjatë të Ewopharma. Falë përvojës së tyre shumëvjeçare në rajon, ata u përgjigjen në mënyrë pragmatike luhatjeve afatshkurtra, pa u shqetësuar apo pa humbur nga sytë objektivat afatgjata. Kjo shkallë e lartë e profesionalizmit ka qenë çelësi i partneritetit tonë, pasi ne mund të mbështetemi tek Ewopharma me besim të plotë, për të vepruar në përputhje me qëllimet e dakorduara.

Në BioGaia, ne mezi presim të zgjerojmë më tej shtrirjen tonë në rajon me Ewopharma dhe kemi besim se ata do të mbeten një nga partnerët tanë kryesorë duke ecur përpara.